

Tiranë, më 28.03.2022

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTLIGJIN "PËR URDHRIN PROFESIONAL TË INXHINIERËVE"

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji propozohet nga Deputetja Znj. Luljeta Bozo.

Prezantimi këtij Projektligji nuk vjen si një dëshirë spontane lindur pas marrjes së statusit të Deputetes në Kuvendin e RSH. Ky prezantim është momenti final i përpjekjeve të filluara që në vitin 2017 nga Grupi Nismëtar për krijimin e UPI-t, pjesë e së cilisë kam qenë që në fillimet e punës.

Më tej në vijim të procesit, me statusin e Kryetares së Shoqatës së Gjeoteknikëve Shqiptarë, jam angazhuar me të gjithë mundësitet për tu bërë promotore e nisjes së një veprimtarie vetërregulluese të gjithë komunitetit inxhinierik, që u materializua për herë të parë në një marrëveshje të shkruar ndërmjet njëmbëdhjetë shoqatave dhe grupimeve të fushave inxhinierike, në datën 16.05.2018.

Kjo marrëveshje do të mundësonë edhe konfigurimin ligor të këtij procesi, tashmë të nisur, vetërregullues, duke ligjëruar UPI-n.

Procesi vetërregullues i komunitetit inxhinerik është :

- ✓ garanci e shtuar për të argumentuar kohën e duhur për miratimin e projektligjit; dhe
- ✓ siguri se ligjërimi i vetërregullimit të nisur do të zbatohet në një hapësirë që me dakordësinë tërësore me projektligjin ka evidentuar gadishmërinë e saj për kornizën ligjore vetërregulluese.

Në momentin e përfundimit të draftimit të projektligjit, pasi kam marrë dakordësinë e Grupit Nismëtar dhe gjithë faktorit inxhinierik, kam filluar nismë individuale për prezantimin e tij në Kuvend.

Të gjithë shoqatat inxhinierike, pasi kanë dakordësuar draftin final, nëpërmjet personave të autorizuar kanë garantuar nëpërmjet një dokumenti shkresor gjithë mbështetjen e tyre për procesin e filluar nëpërmjet kësaj nisme ligjore.

Nga ana tjetër, Projektligji ka përfshirë gjithë vërejtjet dhe probematikat që kanë dalë nga opinonet me shkrim të gjithë komunitetit të inxhinierëve, parashtuar prej tyre në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në të cilën u paraqit Projektligji fillestas.

Projektligji ka si qëllim :

- ✓ rregullimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të marrëdhënieve që lindin ndërmjet, nga njëra anë, gjithë subjekteve që ushtrojnë profesionin e inxhinierit gjatë ushtrimit të veprimitarës së tyre, dhe, nga ana tjetër, subjekteve publike apo private që përfitojnë nga kjo veprimtari;
- ✓ rregullimin e mënyrës së organizmit dhe funksionimit të brendshëm të komunitetit të inxhinierëve

Objektivat që synon të arrijë projektligji janë të lidhura drejtpërdrejtë me :

- ✓ zhvendosjen nga administrata publike tek mekanizmi i ri i Urdhri Profesional i Inxhinierit të përgjegjësisë së prejardhur nga tèresia e problematikave në fushën shërbimeve dhe punëve inxhinierike;
- ✓ rregullimin e profesionit të inxhinierit në funksion të interesit publik;
- ✓ standardizimin e shërbimeve inxhinierike;
- ✓ lirinë e konkurrencës së inxhinierëve;
- ✓ autonominë dhe pavarësinë e gjykimit intelektual e teknik të inxhinierëve;
- ✓ korrektesinë dhe cilësinë e shërbimeve të inxhinierëve në funksion të mbrojtjesë së përfituesve të shërbimeve inxhinierike, në sektorin publik apo privat;
- ✓ ushtrimin korrekt e ligjor të profesionit, pavarësisht nga mënyra apo forma e ushtrimit të tij;
- ✓ lirinë e zgjedhjes nga përfituesit e shërbimive inxhinierike;
- ✓ vijimin e aplikimit të parimit të vetërregullimit i bashkërenduar me parimin e pavarësisë financiare, në kuadër të vendosjes së shtetit të së drejtës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Nevoja e propozimit të këtij Projektligji vjen si pasojë direkte e boshllëkut ligjor krijuar që prej miratimit të ligjit nr. 10171 "Për profesionet e rregulluar në RSH".

Ky akt në shumë dispozita të tij referon UP (Urdhrat Profesionale), duke filluar që nga neni 4/f nëpërmjet të cilit përkufizon UP-në, konkretisht :

f) "Urdhër profesional", më poshtë UP, është enti publik kombëtar, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve në një fushë të caktuar dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

duke vijuar njëtrajtësisht edhe :

- ✓ neni 5/f, që "përcakton inxhinierin si një profesion të rrreguluar";
- ✓ neni 6/2, që "i atribuon UP-së të drejtën për të përcaktuar kriteret për ushtrimin e profesionit";
- ✓ neni 8/1/c, që "parashikon regjistrimin e profesionistit në UP si kriter për ushtrimin e profesionit prej tij";

- ✓ nen 10/2/c, që "i jep të drejtë UP-së të caktojë një anëtar në Komisionin e Provimit të Shtetit";
- ✓ nen 11/1, që "njeh autoritetin e UP-së për të propozuar mënyrën e praktikës profesionale dhe regjistrimin e praktikantëve"
- ✓ nenet 15; 16; 17; dhe 18, që "parashikojnë hapësirat e rregullimeve thelbësore që duhet të përmbushen nga secili UP"

Prej miratimit të atij ligji, asnjë nismë ligjore nuk është propozuar për të ligjëruar ndonjë Urdhër Profesional të gjithë komunitetit inxhinierik, duke pamundësuar zbatimin në praktikë të tij për inxhinierët.

Projektligji i propozuar është vetëm vijimi i një procesi për mbushjen e vakumit ligjor deri në krijuimin e UP-ve për të gjithë profesionet e përkufizuara nga ligji nr. 10171 si profesione të rregulluara.

Me prezantimin e dakordësisë tèresore për Projektligjin, komuniteti inxhinierik ka konfirmuar dukshëm se procesi vetërregullues i tij, me filesa që në nisjen e rrugëtit të ligjërimin e UPI-t, është një proces që i jep këtij komuniteti të drejtën për të qenë nismëtar i një procesi të pakthyeshëm për demokratizimin vijues të gjithë hapësirës që ka të bëjë me profesionet e rregulluara.

Projektligji nuk është pjesë e programit analistik të projektakteve për vitin 2022 por ai është i lidhur ngushtë dhe në të njëtin projeksion me projekt aktet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, parashikuar në tabelën e kësaj Ministrie bashkëngjitur Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 29.12.2021 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analistik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2 date 07.01.2022, respektivisht :

- ✓ Për miratimin e rregullave për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitet e tij profesionale, gjatë ushtrimit të profesionit, parashikuar në rreshtin 13 të tabelës;
- ✓ Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që registrohen në regjistrin elektronik të profesionisteve në fushën e projektimit dhe zbatimit, parashikuar në rreshtin 21 të tabelës; dhe
- ✓ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të sigurimit të përgjegjësisë profesionale të projektuesit, grupit të projektimit dhe zbatuesit të punimeve, parashikuar në rreshtin 22 të tabelës.

Nëpërmjet këtyre akteve Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si qëllim saktësimin dhe plotësimin e procesit rregulator të operimit në fushën e infrastrukturës, përkatësisht :

- ✓ saktësime dhe plotësime të rregullave ekzistuese në mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, në detyrat profesionale të tij, përrritjen e përgjegjësisë në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së punimeve ndërtimore;
- ✓ miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që registrohen në regjistrin elektronik të profesionisteve në fushën e projektimit dhe zbatimit;
- ✓ përcaktimin e rregullave dhe procedurave të sigurimit të përgjegjësisë profesionale të projektuesit, grupit të projektimit dhe zbatuesit të punimeve.

Në këtë linjë, projektligji konfiguron drejt pozicionin ligjor dhe profesional të aktorëve të fushës, përkatësisht inxhinierët e gjithë spektrit, si do shpjegohet në mënyrë të detajuar më poshtë në këtë relacion.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji përbledh aplikimin e gjithë parimeve themelore mbi të cilat janë ndërtuar urdhrat Profesional të Inxhinierëve në BE dhe vende të tjera të zhvilluara. Ky Projektligj është modeluar në referim të ligjit rregulator të Republikës Italiane, "Për Urdhrin Profesional të Inxhinierëve Italianë" duke përshtatur rregullimet e tij në funksion të veçantive të realitetit shqiptar. Për këtë shkak, por jo vetëm, Projektligji prezanton përparësi të cilat do t'i evidentojmë duke shpjeguar shkurtimisht risitë e sjella prej tij, si më poshtë :

Parimi i vetërregullimit

Një nga risitë që sjell projektligji ka të bëjë me garantimin e zbatimit në praktikë të parimit të vetërregullimit, i cili do të nënkuonte që tashmë komuniteti i inxhinierëve me vullnetin e tij të lirë, pa asnjë lloj ndikimi, përfshi edhe atë të grupimeve ekonomiko-financiare, e sigurisht edhe atë politik, ka atributet ligjore jo vetëm për të marrë përsipër përgjegjësitë e tij por edhe të mbrojë interesat e secilit inxhinier në veçanti.

Ky parim merr jetë prej rregullimeve krijuese të projektligjit, si ato që :
nga njëra anë,

barazojnë inxhinierët shqiptarë me gjithë inxhinierët e tjerë të BE-së, hapësirë brenda së cilës nuk ekziston prej kohësh ndonjë mekanizëm licensimi, duke i dhënë atyre të drejtë që të ushtrojnë aktivitetin që nga momenti i diplomimit në respektim të ligjin nr 10171 date 22.10.2009 "Për profesionet e rreguluara"; dhe
nga ana tjetër,

kanë lënë pa fuqi ligjore dispozita kufizuese të cilat detyronin inxhinierët, që për të ushtruar aktivitetin e tyre, t'i drejtohesin një organi të administratës publike, i cili jepte apo hiqte licensa për ushtrimin e aktivitetit.

Ky parim garantohet edhe nga parashikimi ligjor se çdo vendimmarrje e UPI-t realizohet me parimin "një anëtar një votë".

Ky standard i ri garanton edhe një mundësi të re për publikun apo edhe për administratën publike që të përfitojë zgjidhje të qëndrueshme e të besueshme profesionale nga një organizëm tashmë i pavarur, edhe në situata të jashtëzakonshme si fatkeqësi natyrore, tërmete etj.

Regjistri Profesional

Është pasojë direktë e parimit të vetërregulimit. Ky regjistër garanton :

- ✓ ushtrimin e të drejtës së profesionit pa asnjë kufizim brenda profilit të diplomimit;
- ✓ publikimin e listës shteruese të gjithë profesionistëve pjesë e UPI-t shoqëruar me gjithë spektrin individual të kualifikimeve, specializimeve, eksperiencave, masave ndëshkimore, botimeve etj;

- ✓ hapjen e tregut të shërbimeve dhe punëve inxhinierike për nevoja publike apo private. Tashmë janë vetë të interesuarit për të përfituar shërbimet dhe punët inxhinierike, pra organet, entet apo institucionet publike dhe subjektet private që nga lista gjithëpërfshirëse e Regjistrat Profesional të përzgjedhin profesionistin për të cilin kanë nevojë.

Kodi Etik dhe Deontologjik i Inxhinierit

Për herë të parë Inxhinierët do të kenë kodin e tyre etik dhe deontologjik që do të përcaktojë kornizat ligjore të sjelljes dhe qasjes së tyre ndaj detyrimeve profesionale, ndaj kolegëve, dhe ndaj publikut si përfitues i shërbimeve dhe punëve inxhinierike.

Ky kod do të jetë një mundësi më shumë për publikun për të ezauruar të drejtën për tu ankuar ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të inxhinierëve në shkelje të tij.

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

Në praktikën e deritanishme, përjashto raste shumë të rralla, pasojat nga shërbimet apo punët inxhinierike rëndojnë mbi subjektin investitor, publik apo privat.

Projektligji parashikon që për çdo shërbim apo punë inxhinierike, në të gjitha disiplinat, profesionisti duhet të realizojë sigurimin e përgjegjësisë profesionale. Kjo do të garantojë që subjektet e treta përfituese nga shërbimet, administrata publike apo subjektet privat do të jenë të shpërblyer për çdo dëm eventualisht të mundshëm ardhur si pasojë e gabimeve gjatë shërbimeve apo punëve inxhinierike.

Projektligji ngarkon çdo inxhinier që të bëjë me dije përfituesit e shërbimeve të tij, nëpërmjet një deklarate me shkrim, për shumën e vlerës së dëmit të mundshëm të shkaktuar për të cilën ai personalisht është i siguruar nga një shoqëri sigurimi.

Kjo risi pritet të ketë një ndikim shumë të rëndësishëm finaciar.

Në sektorin publik,

administrata publike çlirohet përfundimisht nga detyrimi për të shpërblyer të tretët e dëmtuar nga fatkeqësitet natyrore (tërmetet apo situata të ngjashme) sepse tashmë ky detyrim i është tejkaluar shoqërive të sigurimit pranë të cilave janë siguruar anëtarët e UPI-t.

Në sektorin privat;

Subjektet private që do të përfitojnë një shërbim inxhinierik të ofruar nga profesionistë, anëtarë të UPI-t, shmanget përfundimisht nga rreziku i çdo dëmi të mundshëm, ardhur si pasojë e shërbimeve inxhinierike, sepse pas miratimit të ligjt janë shoqërite e sigurimit pranë të cilave janë siguruar anëtarët e UPI-t, që do të mbulojnë dëmin.

Shoqëritë tregtare që ushtrojnë aktivitet në fushat inxhinierike, janë të detyruara të mbulojnë vetë tarifat e policave të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për anëtarin e UPI-t që punësojnë, pavarësisht pozicionit të punësimit, pra që nga drejtuesi teknik e deri tek inxhinieri zbatues në kantjer.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Deri tanë, inxhinierët janë kujdesur në mënyrë individuale për të vijuar më tej ngritjen e dijeve të tyre profesionale, në varësi të aftësive, mundësive financiare, sferës së njohjes apo faktorë të tjera tërësisht individualë. Kjo qasje e vjetër në asnjë rast nuk ka garantuar se janë përvetësuar zhvillimet më efikase dhe më moderne në fushat inxhinierike por jo vetëm.

Projektligji parashikon që edukimi vazhdues, si detyrë ligjore e çdo anëtar të UPI-t, të garantohet nga vetë UPI.

UPI, si një ent me interes publik, ka kapacitetet e nevojshme akademike dhe financiare për të garantuar se anëtarët e tij, pa asnjë pagesë, do të vijojnë edukimin profesional të tyre me gjithë përditësimet e shkencës inxhinierike nga stafi më i kualifikuar vendas dhe/apo i huaj.

Po ashtu Projektligji, në kuadër të garantimit të zbatimit në praktikë të edukimit vazhdues, parashikon edhe masa disiplinore për anëtarët e UPI-t, që nuk përbushin këtë detyrim ligjor.

Modalitetet, mënyrat dhe afatet e edukimit vazhdues do të janë pjesë e Rregullore/s/ve të UPI-t, të cilat do të miratohen brenda afateve që parashikon ky Projektligji.

Opinione dhe ekspertiza tekniko-inxhinierike më të kualifikuara dhe të garantuara.

UPI do të përfshijë brenda tij gjithë profesionistët, sigurisht, ndërmjet tyre janë edhe më të mirët e çdo fushe inxhinierike.

Aktualisht opinione dhe ekspertiza tekniko-inxhinierike marrin organet e drejtësisë, organe, ente dhe institucionë publike apo edhe vetë subjektet private. Në çdo rast për shkak të kaosit në të cilin operojnë anëtarët e ardhshëm të UPI-t, opinionet dhe ekspertizat janë vënë gjithnjë në dyshim dhe deri në mbërriten e Projektligjit nuk evidentohej asnjë organ i cili përfundimisht të saktësonte kush ishte opinioni apo ekspertiza që vlente.

Projektligji i jep fund kësaj situate. Ai parashikon UPI-n si enti i pavarur dhe më i besueshmi profesionalisht për të dhënë opinione dhe ekspertiza. Kjo detyrë i është caktuar Këshillit Drejtues të UPI-t, të cilit nëpërmjet mekanizmave të rregullimit të brendshëm, Projektligji i ka dhënë mundësinë që nëpërmjet specialistëve më të spikatur, të mbledhur në mënyrë kolegiale, të konkludojnë me opinione dhe ekspertiza tekniko-inxhinierike të kërkua nga çdo subjekt i tretë.

Projektligji i jep zgjidhje edhe problematikave të rasteve të kundërshtive ndërmjet opinioneve të vetë anëtarëve të UPI-t. Komisionet e Posaçme të UPI-t garantojnë dhënien e një opinioni të

certifikuar, detyrues për anëtarët e tij pjesë e kundërshtive duke garantuar edhe dijeninë e subjekteve të treta të interesuar për rastin e kundërshtisë.

Disiplinimi i shërbimit inxhinerik

Kjo risi në fakt përbën një nga elementet më të rëndesishëm dhe argumentet më të qënësishme për të motivuar domosdoshmérinë e krijimit të UPI-it. Deri tani, nuk ka asnjë indikator që të demonstrojë ekzistencën e ndonjë grime disiplinë në shërbimet inxhinierike. Organet e administratës publike që lisensojnë inxhinierët, japid licensën dhe nuk disponojnë asnjë mekanizëm për të marrë informacionin e nevojshëm vijues se si po operon i licensuari gjatë shërbimeve inxhinierike, e po ashtu për ndëshkimin e profesionistit në rastet e dhënies së shërbimeve në kundërshtim me normat teknike dhe etike. Për më tepër këto organe nuk kanë kapacitetet duhura akademike të fushës për të përcaktuar drejt rastin. Praktikisht nuk gjejmë dot gjurmë të ndonjë rasti kur është hequr licensa e dhënë, pasi është ndjekur një procedurë që nuk mund të vihet në diskutim.

Po ashtu, prezumohet dija e kujtdo që vendimet për shërbimet inxhinierike nuk merren nga inxhinierët por nga punëdhënsit e tyre apo përfituesit e shërbimeve, pra nga ata që përballojnë kostot e shërbimeve, duke :

- ✓ kushtëzuar një situatë pasigurie të pranisë së garancive afatgjata në shfrytëzimin e veprave inxhinierike, apo,
- ✓ mos garantuar prej fillimit standardin e parashikuar dhe të mbuluar financiarisht nga investitori.

Projektligji i jep fund edhe kësaj gjendjeje të papranueshme. Në një kre të veçantë të tij parashikohet problematika disiplinore që ka të bëjë me rregullimet ligjore nga momenti i krijimit të Këshillit Disiplinor, deri tek marrja e masave disiplinore dhe regjistrimi i tyre në Regjistrin Profesional. Karakteristika themelore e këtij këshilli është se ai është një organ i posaçëm që zgjidhet njësoj si organet e tjera të UPI-t nëpërmjet parimit "një anëtar një votë" nga Asambleja e Përgjithshme e UPI-t, pra nga têrësia e anëtarëve.

Ky Këshill ka kompetencën që të gjykojë apo vlerësojë gjatë ushtrimit të profesionit çdo anëtar të urdhrit, përfshi edhe Kryetarin e UPI-t.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me :

- ✓ nenin 81 të Kushtetutës;
- ✓ me ligjin nr. 10171 "Për profesionet e rregulluara";
- ✓ me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me ligjet nr. 9200, datë 26.2.2004; nr.9794, datë 23.7.2007; nr.9826,

datë 11.11.2007; nr.10324, datë 23.9.2010; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 8.6.2011; nr.11/2012, datë 9.2.2012; nr.20/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.1.2020.

Ky projektligji përfaqëson një nivel më të përparuar të rregullimit të urdhrit Profesional të Inxhinierit në kahasim me shumë vende të BE-së, për sa kohë që draftimi i tij është përkrahur, nxitur, orientuar, mbështetur dhe garantuar nga dy urdhrat më prestigjoë të inxhinierëve në BE, Urdhërit Nacional Italian të Inxhinierit (CNI), si dhe nga Shoqata e Inxhinierëve të Mbretërisë të Hollandës (KIVI).

Projektligji ka përfshirë gjithë hapësirën rregullatore të marrëdhënieve të UPI-t duke rregulluar edhe atë hapësirë problematike që është evidentuar tek dy urdhrat e mësipërm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME AQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj garanton të njëtin nivel rregullimi të marrëdhënieve të fushës si të gjithë ligjet e vendeve të BE-së për urdhrat profesionalë të inxhinierit, për më tepër përfaqëson një rregullim avagard të fushës, duke qenë në të njëtin nivel që orienton Direktiva 36/2005/CE e Parlamentit Evropian.

Ky projektligj përbush në mënyrë optimale detyrimet e parashikuara në nenet 49-59 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociiimit (MSA) si dhe me detyrimet afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara nga Partneriteti Evropian i nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në shkurt 2008.

Garanci për nivelin e lartë rregulator të projektligjit është fakti se ai është hartuar me mbështetjen zyrtare të Urdhërit Nacional Italian të Inxhinierit (CNI) dhe të Shoqatës së Inxhinierëve të Mbretërisë të Hollandës (KIVI) dhe është certifikuar prej tyre.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur ka në përmbajtjen e tij tetë kapituj :

- Dispozita të përgjithshme;
- Organizimi dhe funksioni i UPI-t;
- Asamblesja e Përgjithshme e UPI-t;
- Këshillit Drejtues i UPI-t;
- Këshillit Disiplinor i UPI-t;
- Regjistri Profesional i UPI-t;
- Detyrat, të drejtat dhe etika e anëtarit të UPI-t
- Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Me dispozitat e përgjithshme janë përcaktuar, si zakonisht në praktikën legislative, objekti, qëllimi, fusha e zbatimit dhe përkufizimet e termave të përdorura gjatë tërësisë së tij.

Në këtë pjesë hyrëse është përcaktuar qartë vullneti për të krijuar UPI-n, duke prezantuar që në fillim garancinë se ky mekanizëm i ri do të organizohet dhe funksionojë nga njëra anë në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonominë profesionale, dhe nga ana tjeter në mbrojtjen dhe garantimin e standardeve në formimin dhe ushtrimin e profesionit të inxhinierit.

Për tu përmendur është se projektligji parashikon zbatueshmérinë e tij mbi çdo inxhinier shqiptar, të huaj apo pa shtetësi që ka dëshirë të ushtrojë profesionin e tij në Republikën e Shqipërisë.

Në kreun e dytë janë përcaktuar statusi, logoja, organet drejtuese dhe funksionet. Bie në sy menjëherë statusi potencial që merr UPI, si një ent :

- ✓ publik kombëtar, jo fitimprurës dhe i pavarur nga të tretë;
- ✓ me autonomi të plotë financiare, funksionale, administrative;
- ✓ me pavarësi të brendshme të plotë në vlerësimin dhe gjykimin e veprimtarisë së çdo anëtarë të UPI-t.
- ✓

Për sa i përket rregulimit të funksionimit të brendshëm të UPI-t projektligji parashikon miratimin e Rregulloreve të UPI-t. Rregulloret miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e UPI-t ndërsa ministria e linjës, verifikon përputhshmérinë ligjore të saj pas miratimit.

Projektligji ka parashikuar edhe Organet drejtuese të UPI-t të cilët janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Këshilli Drejtues;
- Këshilli i Disiplinës;
- Kryetari.

Në kreun e tretë trajtohet rregullimi i funksionimit të Asamblesë së Përgjithshme të UPI-t, e cila është organi më i lartë në hierarkinë e tij. Për shkak të kësaj rëndësie, kreu parashikon në mënyrë të detajuar mënyrën si thirret, kohën e thirrjes, procedurën dhe kohën e njoftimit të thirrjes, kuorumin, të drejtën e votës, mënyrën e votimit, dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

Në kreun e katërt trajtohet rregullimi i funksionimit të Këshillit Drejtues të UPI-t, i cili është organi përfaqësues dhe qeverisës i UPI-t. Kreu parashikon mënyrën e zgjedhjes dhe organin që i zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues, i cili si organet e tjera të UPI- zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme, gjithnjë me parimin "një anëtar një votë". Gjithashtu parashikon përbërjen, dhe kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve, pa harruar veprimtarinë, detyrat dhe kompetencat e Këshillit Drejtues.

Po në këtë kre parashikohen edhe detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të UPI-t, si një prej organeve të tij.

Këtij kreu i shtohet edhe rregullimi i pavarësisë financiare të UPI-t dhe procesi i ankimimit të anëtarëve të UPI-t në Këshillin Drejtues.

Në kreun e pestë trajtohet rregullimi shterues i tèresisë së optikës së veprimit të Këshillit Disiplinor. Rregullimi përbledh përbërjen, kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve, njësinë strukturore organizative bazë të funksionimit, rastet e nisjes së procedimit disiplinor, masat disiplinore që mund të merren, mënyrën e përzgjedhjes së masës, kohëzgjatjen e vlefshmërisë së masave disiplinore, procesin e ankimit administrativ brenda UPI-t, dhe së fundmi parashikon të drejtën e anëtarit të ndëshkuar me masë disiplinore për t'ju drejtuar gjykatës.

Në kreun e gjashtë parashikohen rregullimet e Regjistrat Profesional, të cilat përfshijnë subjektet që mund të regjistrohen, kriteret e regjistrimit, mënyra e kërkesës për regjistrim dhe afati i nevojshëm për regjistrim, organin që e administron Regjistrin, të drejtat që lindin për subjektet që regjistrohen, etj.

Në kreun e shtatë parashikohen rregullimet që kanë të bëjne me të drejtat dhe detyrat, etikën e anëtarëve të UPI-t, duke i përcaktuar ato qartë e në mënyrë shteruese. Projektligji parashikon miratimin prej UPI-t, pas hyrjes në fuqi të ligjit, të Kodit Etik Deontologjik të inxhinierit.

Në këtë kre, për shkak të rëndësisë, parashikohet në dispozita të veçanta edhe detyrimi anëtarëve të UPI-t për sigurimin e përgjegjësisë profesionale dhe e drejta e tyre për edukimin vijues profesional pa pagesë.

Në kreun e tetë parashikohen rregullimet e periudhës tranzitore nga hyrja në fuqi e ligjit deri në mandatimin e organeve drejtuese të UPI-t, duke përcaktuar rigorozisht edhe teknikalitetet e procedurave fillestare deri në vijimin e funksionimit normal.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij akti në referim të nenit 28 dhe 29 të tij ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave, për të përcaktuar përbërjen, fondet përkatëse dhe mënyrën e funksionimit të strukturave përgjegjëse për periudhën kalimtare.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKLIGJIT

Nismëtar për krijimin e Urdhrit të Inxhinierit është SHOSHIK (Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë), e krijuar në vitin 2001.

Zyrtarizimi i përpjekjeve fillon që nga data 19.06.2017 kur SHOSHIK-u ju drejtua me anë të një letre zyrtare Kryeministrat të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim, në datën 21.11.2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe SHOSHIK është lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit (nr. 2193 Prot) me qëllim ngritjen e Urdhrit të Inxhinierit, si mekanizmi i vetëm që do të garantonte sipas kësaj Marrëveshjeje, ndërmjet të tjera, edhe:

- përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve dhe shërbimeve në fushat inxhinierike;
- përmirësimin, ngritjen e cilësisë dhe disiplinimin e oponencave teknike të projekteve inxhinierike.

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të ngrihej edhe Grupi i Përbashkët i Punës me detyrë hartimin e një Draft Ligji mbi krijimin e Urdhërit Profesional të Inxhinierit në Republikën e Shqipërisë.

Për të garantuar një proces si të standardeve më të mira të BE-së, SHOSHIK ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi përkatesisht :

- në datën 24 janar 2018, në Romë, me National Council of Italian Engineers (NCI) (Urdhrin Italian të Inxhinierit, krijuar në vitin 1923)
- në muajin janar 2019 me Royal Netherlands Society of Engineers (KIVI) (Urdhrin Hollandez të Inxhinierit, krijuar më 31 gusht 1847)

me qëllim që NCI dhe KIVI të mbështetnin SHOSHIK-un gjatë të githë rrugëtimit të tij për krijimin e Urdhrit Shqiptar të Inxhinierit, përfshi procesin draftues të ligjit dhe ndihmën për organizimin dhe funksionimin e tij pas miratimit të ligjit.

Në datën 16.05.2018 është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet grupimeve të ndryshme inxhinierike, shumica prej tyre pjesë e Grupit Nismëtar, qëllimi i së cilës ishte përfundimi me sukses i punës së nisur nga Grupi Nismëtar për miratimin e ligjit për UPI-n.

Në maj të vitit 2018 grupi nismëtar i UPI-t, me cilësinë e anëtarit të FIDIC ka marrë pjesë në Forumin e Sofies, Bullgari, me temën "Për perspektivat Europiane të organizatave inxhinierike të Ballkanit Perëndimor." Ky forum u organizua nga Këshilli i Europës me pjesëmarrjen e të gjithë organizatave inxhinierike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim inkurajimin e tyre për krijimin e Urdhave Profesionalë të Inxhinierëve.

Me shkresën e saj datë 23 tetor 2018, Royal Netherlands Society of Engineers (KIVI) ka konfirmuar se :

"Ligji është në përpunë me standartet e aplikueshme në BE dhe mund të implementohet në mjedisin ligjor dhe ekonomik të RSH"

Projektdrafti i parë është dorëzuar nga Grupi Nismëtar në MIE në datën 19.11.2018, duke bërë me dije në të njëtin kohë edhe Kryeministrin; dhe ministrat përkates të MIE; MARS; MD; dhe MSHMS, përfaktin se SHOSHIK-u kishte tejkluar gjithë pengesat për t'i hapur rrugë fillimit të procedurave për miratimin e ligjit për UPI-n.

Në datën 07.12.2018 në ambjentet e UET-it është zhvilluar një takim i organizuar nga Grupi Nismëtar, SHOSHIK, SHASH dhe MIE, me pjesëmarrjen e akademikëve nga fusha e inxhinierisë, si dhe inxhinierëve dhe arkitektëve profesionistë. Drejtori Ekzekutiv i CNI-së prezantoi Draftligjin e dorëzuar të UPI-t duke theksuar rëndësinë e tij si një ligj që nuk mund të bënte asnjë dallim nga aktet e BE-së në fushën inxhinierike dhe nga ligjet e urdhreve të Inxhinierëve në BE.

Publikimi i eventit shërbeu për të vijuar procesin e marrjes në konsideratë të përshtypjeve, opinioneve, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga të gjitha grupet e interesit. Këto sugjerime i diskutuan midis nesh, si dhe i përcollëm te partnerët tanë, CNI dhe KIVI.

Me shkresën e MIE-së, nr. 261 Prot datë 09.01.2019, është udhëruar "Ngritja e Grupit të punës për hartimin e projektligjit për UPIN", në përbërje të të cilët ishte edhe z/Minitri i MIE-së dhe anëtarët e Grupit Nismëtar. Grupi i Përbashkët i Punës ka vijuar menjëherë punën jo vetëm me mbledhje të përbashkëta por edhe me takime e diskutime të hapura me publikun dhe grupet e interesit.

Grupi i Përbashkët i Punës, për të rakorduar gjithë punën për draftimin e ligjit me partnerët ndërkombëtarë të Grupit Nismëtar, të cilët kanë qenë pjesë e procesit që nga fillimi i tij, organizoi respektivisht :

- në datat 18-19.02.2019 në ambjentet e Ambasadës Italiane në Tiranë, diskutime me përfaqësuesit e CNI-së, dhe
- në datën 26.02.2019 një takim të hapur, të gjerë me pjesëmarrje të grupeve të ndryshme të interesit, akademikëve, medias, dhe çdo profesionisti të lirë, në të cilin relatoi edhe Drejtoresha Ekzekutive e KIVI-t, znj.Micaela Dos Ramos.

Të dy partnerët, si pjesë e procesit, riafirmuan mbështetjen e tyre për projektligjin së bashku me rekomandimet përfundimtare.

Pas përmbylljes së procesit të draftimit,

- në kuadrin e përfshirjes së tyre për të vijuar procesin e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të projektligjit "Për urdhrin profesional të inxhinierëve";
- në konfirmimin e vullnetit të tyre materializuar me draft projektin e ligjit;
- duke admiruar gjithë procesin transparent dhe demokratik e gjithëpërfshirekës të gjithë grupeve të ligjshme të interesit të ndjekur prej tyre që nga fillimi i procesit deri në hartimin e draft projektit të ligjit;
- të angazhuar për të garantuar ligjshmërinë e të gjithë procesit të ndjekur prej tyre që nga fillimi i nismës për hartimin e projekt ligjit deri në miratimin e tij,

të gjithë aktorët aktiv pjesmarrës në proces, konkretisht 11 (njëmbëdhjetë) shoqata dhe grupime inxhinierike :

- Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë (SHOSHIK);
- Shoqata e Gjeodetëve te Shqipërisë;
- Shoqata e Agro Mekanizmit të Shqipërisë;
- Shoqata e Gjeoteknikëve;
- Shoqata e Gjeologëve të Shqipërisë;
- Shoqata e Markshajderëve dhe Gjeomatikës;
- Grupimi i Inxhinierëve të Përpunimit të Drurit dhe Pyjeve;
- Shoqata e Inxhinierëve të Minierave dhe Gjeologëve;
- Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Sizmik;
- Unioni i Ekspertëve Mjedisorë Shqiptarë;
- Shoqata e Inxhinierëve Projektues të Veprave në Ndërtim.

nënshkruan "Marrëvhjen e bashkëpunimit përmes mbështetjen e procesit të miratimit të ligjit "Për urdhrin profesional të inxhinierëve", nëpërmjet të cilës autorizon edhe përfaqësuesit e tyre.

Po ashtu, Draftligji ka marrë vërejtjet dhe opinionet edhe nga masa e gjerë e faktorit inxhinierik shqiptar nëpërmjet organizimit të takimeve të mbajtura në Universitetin Shtetëror dhe në ato private në Tiranë, në takime të hapura të pakufizuara me pjesëmarrjen të gjithe profesionisteve të

interesuar, duke e bërë publik Draftligjin nëpërmjet rrjeteve sociale, si dhe në një takim përbyllës në korpusin e Universitetit Shtetëror të Tiranës, në prani të mediave dhe duke e pasqyruar atë direkt në rrjete sociale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk afekton në mënyrë të drejtëpërdrejtë të ardhura buxhetore. Në nenin 15 të tij është parashikuar se si burim i të ardhurave të UPI-t do të jenë :

- ✓ kuotizacioni i anëtarëve;
- ✓ donacione të ndryshme, dhe të ardhura të tjera të deklaruara dhe të ligjshme, të cilat nuk përbëjnë konflikt interesi;
- ✓ financime nga projektet në të cilat UPI merr pjesë.

Pavarësia financiare në vendimarrje si një kriter shumë domethënës për të mundësuar një pavarësi në vendimarrjet dhe funksionimin e UPI-t është e garantuar nga neni 15 "burimet e financimit të UPI-t dhe përdorimi i tyre".

Paraprakisht kam bërë një parashikim në formë projektbuxheti me të cilin jam munduar të përfshij gjithë fondin e shpenzimeve të domosdoshme për të tejkaluar vetëm periudhën kalimtare, në referim të neneve 28 dhe 29 të projektligjit.

Në bazë të këtij parashikimi fondi është përllogaritur në vlerën prej **1,103,320.00 Euro**.

Menjëherë pas ngritisë së strukturave të UPI-t, pas hyrjes në fuqi të ligjit, Projektbuxheti do të rishikohet nga Këshilli i Përgjithshëm Drejtues dhe do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e UPI-t.

Përdorimi i fondit është i shpjeguar në mënyrë të detajuar në dokumentin "preventivi i buxhetit", i cili i bashkëngjitet këtij relaciioni së bashku me dokumentin e strukturës së UPI-t.

LULJETA BOZO

DEPUTETE E QARKUT TIRANË



PROJEKT BUXHET PËR VITIN E PARË PËR UPI-n

Nr	EMËRTIMI	persona	shpenzime mujore		shpenzime vjetore
			pag. Personale	vj mujore totali	
t ë p ë r h e r s h ë m f o n d p a g e k o h ë p j e s s h m e	A DREJTORIA EKZEKUTIVE	5		€ 7,200.00	€ 86,400.00
	1 DREJTORI	1	€ 2,000.00	€ 2,000.00	€ 24,000.00
	2 Zv. DREJTORI	1	€ 1,300.00	€ 1,300.00	€ 15,600.00
	3 Sekretar i përgjithshëm	1	€ 1,300.00	€ 1,300.00	€ 15,600.00
	4 Sekretaria	2	€ 1,300.00	€ 2,600.00	€ 31,200.00
	B DEP JURIDIK	2		€ 2,500.00	€ 30,000.00
	1 DREJTORI	1	€ 1,500.00	€ 1,500.00	€ 18,000.00
	2 JURIST	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00	€ 12,000.00
	C DEP I POLITIKAVE EKONOMIKE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE FINANCË	7		€ 6,100.00	€ 73,200.00
	1 DREJTORI - Specialist i politikave ekonome dhe marrëdhënieve me jashtë	1	€ 1,300.00	€ 1,300.00	€ 15,600.00
	2 Financat	6	€ 800.00	€ 4,800.00	€ 57,600.00
	D Dep. I SHËRBIMIT	3		€ 2,200.00	€ 26,400.00
	1 PËRGJEGJËSI - Specialist i IT	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00	€ 12,000.00
	2 IT + Shërbime zyre ,pritje etj	2	€ 600.00	€ 1,200.00	€ 14,400.00
	E DREJTORIA E DISIPLINËS	2		€ 3,300.00	€ 39,600.00
	1 DREJTORI	1	€ 2,000.00	€ 2,000.00	€ 24,000.00
	2 Zv. Drejtori	1	€ 1,300.00	€ 1,300.00	€ 15,600.00
	SHUMA PËR PERSONELIN E PËRHERSHËM		19	€ 21,300.00	€ 255,600.00
p a g e k o h ë p j e s s h m e	F DEPARTAMENTI I KONSULENCËS TEKNIKE	16		€ 4,150.00	€ 49,800.00
	1 SHEFI I DEP	1	€ 400.00	€ 400.00	€ 4,800.00
	2 Specialistë nga fusha të ndryshme të inxhinierisë	15	€ 250.00	€ 3,750.00	€ 45,000.00
	G DEPARTAMENTI I DISIPLINËS	15		€ 3,900.00	€ 46,800.00
	1 Kryetarë të Komisioneve	3	€ 300.00	€ 900.00	€ 10,800.00
	2 anetarë të komisionit	12	€ 250.00	€ 3,000.00	€ 36,000.00
	E ZYRAT RAJONALE	5		€ 5,000.00	€ 60,000.00
	1 Tirana	2	€ 1,000.00	€ 2,000.00	€ 24,000.00
	2 Vlora	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00	€ 12,000.00
	3 Elbasani	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00	€ 12,000.00
	4 Shkodra	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00	€ 12,000.00
	KËSHILLI DREJTUES	26		€ 5,500.00	€ 66,000.00
	1 KRYETARI	1	€ 500.00	€ 500.00	€ 6,000.00
	ANËTARË TË KËSHILLIT TË DREJTUES	25	€ 200.00	€ 5,000.00	€ 60,000.00
	KESHILLI I DISCIPLINES	15		€ 4,000.00	€ 48,000.00
	1 KRYETARI	1	€ 500.00	€ 500.00	€ 6,000.00
	ANËTARË TË KËSHILLIT TË DISCIPLINËS	14	€ 250.00	€ 3,500.00	€ 42,000.00
	SHUMA PËR PERSONELIN ME KOHË TË PJESSHME		77	€ 22,550.00	€ 270,600.00
SHUMA TOTALE PËR URDHRI VITI I PARË (PJESA SHQIPTARE)		96		€ 43,850.00	€ 526,200.00

			ASISTENCË NGA CNI DHE KIVI	2				€ 96,000.00	
A S I S T E N C A	H	1	Specialisët të atashuar nga CNI dhe KIVI parashikuar 2 persona për 4 muaj	2	€ 5,500.00	€ 11,000.00	€ 44,000.00		
		2	Akomodimi i specialistëve të huaj për 240 ditë				€ 40,000.00		
		3	Shpenzime udhetimi për specialistët e KIVI dhe CNI llogaritur nga dy udhëtime në muaj $4 \times 2 = 8 \times 2 = 16$	0		€ -	€ 12,000.00		
T E T J E R A	J	INFRASTUKTURA						€ 481,120.00	
		1	Hartimi dhe vënia në punë e web-it dhe platformës on-line përfshirë votimin online dhe përpunim të dhënat dhe statistika.		€ -	€ -	€ 100,000.00		
		2	Pajisje dhe arredim i zyrave				€ 160,000.00		
		3	Shpenzime transporti (karburant)				€ 80,000.00		
		4	Logistikë (transferimi dhe përshtatja e licensave ekzistuese sipas kategorive në regjistrin e urdhrit)	6	€ 800.00	€ 4,800.00	€ 57,600.00		
		5	Qira pwr zyrat e UPI-t në Selinë Qëndrore dhe 4 Zyrat Rajonale, kancelari dhe të tjera pér shërbim dhe priti, energji, ujë, internet, pastrim etj shto edhe përkthimet e dokumentacioneve nga urdhurat partnere		€ 290.00	€ 6,960.00	€ 83,520.00		
SHUMA TOTALE PËR URDHRIN VITI I PARË (TË TJERA)							€ 577,120.00		
SHUMA E SHPENZIME PËR VITIN E PARË							€ 1,103,320.00		

STRUKTURA E URDHrit TË INXHINIERIT (PROJEKT)

• ME KOHË TË PJESSHME : **76 persona**

1) KËSHILLI DREJTUES	25 persona
a) Kryetari	1
b) Këshilli	24
2) KËSHILLI I DISIPLINËS	15 persona
a) Kryetari	1
b) Këshilli	14
3) DEPARTAMENTI I KONSULENCËS TEKNIKE	16 persona
a) Shefi i Departamentit	1
b) Specialistë në fusha të ndryshme	15
4) DEPARTAMENTI I DISIPLINËS	15 persona
a) Kryetarët e Komisioneve	3
b) Anëtarë	12
5) ZYRAT RAJONALE	5 persona

• ME KOHË TË PLOTË : **19 persona**

a) Drejtoria	5 persona
1. Drejtori	1
2. Zv.Drejtor	1
3. Sekretar i Përgjithshëm	1
4. Sekretaria	2
b) Departamenti juridik	2 persona
1. Drejtori Juridik	1
2. Jurist	1
c) Departamenti i Politikave ekonomike dhe Marrëdhënieve me jashtë	7 persona
1. Drejtori i marrëdhënieve me jashtë	1
2. Financa dhe zyrat rajonale	6
d) Departamenti i shërbimit	3 persona
1. Përgjegjësi i IT	1
2. IT dhe shërbime zyrë pritje	2
e) DREJTORIA E DISIPLINËS	2 persona
1. Drejtori	1
2. Zv.Drejtori	1